REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**
**KRYETARI**

1068

Maliq më 19.2.2026

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr.12 Datë19.02.2026**

**PËR**
**MBLEDHJEN E TAKSAVE VENDORE NËPËRMJET AGJENTIT TATIMOR**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 64, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", të ndryshuar, Kreu VII, neni 35 " *Tarifat vendore dhe administrimi i tyre*" pika 2 në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar Ligji nr 9902/2008 " *Për mbrojtjen e konsumatorëve*" dhe nevojës për rritjen e eficensës së mbledhjes së të të ardhurave i propozojmë Këshillit :

I. Të miratojë mbledhjen e Taksave dhe Tarifave vendore nëpërmjet Agjentit Tatimor për taksapaguesit familjarë.
II. Taksat dhe Tarifat vendore që do të mblidhen nëpërmjet agjentit tatimor janë:
- Taksë ndërtesë
- Taksë trualli
- Taksë toke
- Tarifat: pastrim, ndriçim, gjelbërim, për mirëmbajen e varrezave dhe tarifë për mirëmbajtje kanale kulluese

III. Agjenti tatimor ngarkohet që të përfshijë taksat/tarifat vendore në faturën e vet, të arkëtojë pagesat për llogari të Bashkisë Maliq si dhe të transferojë të ardhurat e mbledhura brenda afateve të përcaktuara.
IV. Bashkia Maliq ngarkohet të lidhë Kontratë me agjentin tatimor ku të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e paleve, procedurat e mbledhjes dhe të transferimit të fondeve si dhe kompensimin e shërbimit të kryer.
III. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave , Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike.
IV. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", indryshuar

**KRYETARI I BASHKISË**

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@.bashkiamaliq.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

1088 09.2.26

RELACION
PËR

"PROJEKT- VENDIMIN PËR MBLEDHJEN E TAKSAVE VENDORE NËPËRMJET AGJENTIT TATIMOR"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 64, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", të ndryshuar, Kreu VII, neni 35 " *Tarifat vendore dhe administrimi i tyre*" pika 2, ku thuhet se Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre si dhe përcakton nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent tatimor. Ky relacion ka për qellim të informojë Këshillin e Bashkisë mbi arsyet, nevojën dhe përfitimet e miratimit të projekt-vendimit për mbledhjen e takave/tarifave vendore për taskapaguesit familjarë nëpërmjet agjentit tatimor.

Bazuar në strukturën funksionale dhe paketën fiskale të miratuar, administrimi i taksave vendore realizohet nëpërmjet strukturave të Bashkisë nga e cila rezulton se realizimi i planit të të ardhurave është në masën 62% të planit të parashikuar. Në mënyrë që të rritet realizimi i planit të të ardhurave propozojmë që taksat vendore të arkëtohen nëpërmjet një agjenti tatimor (SHRUKK), kundrejt një kompenismi të caktuar për shërbimin e kryer.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë mbulon me shërbim 10870 familje, ndërsa pjesa tjetër e familjeve që nuk mbulohen me shërbim nga ujësjellësi (6130) do të ndiqen nga strukturat e bashkisë për arkëtimin e vitit fiskal aktual si dhe vlerën debitore. Për një mbledhje të të ardhurave sa më efikase, të cilat përkthehen në shërbime dhe punë publike, propozojmë që të lidhim marrëveshje bashkëpunimi me një agjent tatimor përzgjedhjen e të cilit dhe lidhjen e kontratës e ka për detyrë funksionale Kryetari i Bashkisë.

Përparësitë e mbledhjes së taksave vendore nëpërmjet agjentit tatimor:

1. Rritje e efiçencës së arkëtimit duke qënë se agjenti tatimor është më i specializuar, ka përvoje si dhe detyrimi do shtohet në faturën e ujit që e bën të detyrueshëm pagesën e taksave vendore.
2. Detyrimi i taksapaguesve familjarë do të jetë i përpjestuar për 11 muaj, e cila lehtëson barrën administrative të qytetarëve.
3. Rritje e numrit të taksapaguesve, pasi detyrimi për të paguar taksat dhe tarifat vendore do të kryhet për çdo familje të cilat janë identifikuar që disponojnë një pasuri të paluajtëshme në Bashkinë Maliq, detyrohen të paguajnë tarifat lokale.
4. Bashkia do të ulë shpenzimet për staf shtesë.
5. Rritje e fokusit të Bashkisë për realizimit e shërbimeve publike dhe rriten e transparencës dhe gjurmueshmerinë e të ardhurave.

Konceptoi: J. Grabocka

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@.bashkiamaliq.gov.al